

KUVENDI  
KOMUNAL  
V U S H T R R I  
01.Nr.706/04  
Më:28.09.2004



MUNICIPAL  
ASSEMBLY  
VUSHTRRI

Në bazë të nenit 22.1 të Rregullorës nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës dhe nenit 6 pika 6.13 të Rregullorës Komunale për politikën buxhetore dhe procedurat për menaxhim financiar dhe përgjegjësit, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 28.09.2004 muarr këtë:

### V E N D I M

#### **Për lejimin e ndarjes së ndihmës materiale për familje të dëshmorëve të luftës**

##### **Neni 1.**

Me këtë Vendim lejohet ndarja e ndihmës materiale në shumë prej 50 € për çdo muaj, për familjarët e dëshmorëve të luftës të UÇK-ës.

##### **Neni 2.**

Mjetet në emër të ndihmës materiale si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrisë-Shtylla buxhetore për shëndetësi dhe përkujdesje sociale.

##### **Neni 3.**

Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale që në bashkpunim me Shoqatën e familjeve të dëshmorëve të UÇK-ës të përgadit regjistrin e familjeve të dëshmorëve të cilëve do të ju ndahet ndihma.

Regjistri i dëshmorëve të luftës është shtojcë i këtij Vendimi.

##### **Neni 4.**

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të zbatohet nga data 1 Tetor 2004, në një afat deri në rregullimin me Ligj të Statusit të Dëshmorit të luftës.

##### **Neni 5.**

Për zbatimin e drejtë të këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për shëndetësi dhe përkujdesje sociale, Drejtoria për Thesar, buxhet dhe financa dhe Shoqata e familjarëve të Dëshmorëve të luftës të UÇK-ës.

Kryetari i Kuvendit – K.P.F.

**Muharrem Shabani**